



### KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilić

## E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.22.01.2025, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Bajram Hashani, Labinot Mirena, Sami Ahmeti, Albana Shillova Shalaku dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: përf. e Kforit

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstataoi se ka kuorum filloj mbledhjen me këtë:

### R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti i Punës së Kuvendit Komunal për periudhën Janar – Dhjetor 2024
4. Raporti financiar i shpenzimeve Janar-Dhjetor 2024
5. Shqyrtimi i kërkesave
6. Të ndryshme

**Kryesuesja** – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7vota për.

**Pika 1 e rendit të ditës**

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

**Pika 2 e rendit të ditës**

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 6 vota për dhe 1 votë abstenim.

**Pika 3 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti Raportin e punës së Kuvendit Komunal për periudhën Janar-Dhjetor 2024.

**Enver Gashi** – Ne jemi për atë që Raporti i punës së Kuvendit të shkoj në Kuvend dhe meqë, është mbledhja e parë anëtarëve të Komitetit iu dëshiroj punë të mbarë dhe të suksesshme për këtë vit.

**Sami Ahmeti** – Ky është një raport i përgjithshëm dhe ajo që unë vërej është se mungon si në këtë raport ashtu edhe te raporti finançiar i Komunës, pjesa e financave. Për me qenë një raport komplekt qenë mirë me qenë e përfshirë edhe kjo shpenzimet gjatë këtij viti. Përndryshe, ne jemi dakord edhe këto çështje i bisedojmë edhe në seancë.

**Kryesuesja** – Sa i përket raportit financiar edhe unë kam bisedue me drejtoreshën e cila tha se do ti bashkangjitet raportit të Kryetarit në momentin që vjen për vitin paraprak dhe është për të gjitha shpenzimet. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal Raportin e punës së Kuvendit komunal për periudhën janar-dhjetor 2024.

**Pika 4 e rendit të ditës**

**Kryesuesja** – Paraqiti raportin financiar të shpenzimeve Janar-Dhjetor 2024.

**Enver Gashi** – Është një raport finansiar që edhe pse nuk është në detaje është me kohë dhe ne si grup nuk kemi ndonjë vërejtje, jemi për atë që të shkoj në Kuvend.

**Sami Ahmeti** – Ne jemi plotësisht dakord që kjo pikë e rendit të ditës të shkoj në mbledhjen e Kuvendit, ndërsa a është i përgjithshëm apo i detajuar këto i bisedojmë në seancë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal Raportin finansiar të shpenzimeve Janar-Dhjetor 2024.

#### Pika 5 e rendit të ditës

**Kryesuesja** - Ju njoftoj se e kemi një rekomandim nga kryesuesi i Komiteti për komunitete fillimisht për rregullimin e ujit të pijshëm dhe kanalizimit, pastaj të vazhdohet me projektin për eficiencë energetike në banesat sociale në fshatin Plementin. Mendoj se ky rekomandim si i tillë duhet të shqyrtohet në DSHPE.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht ia rekomanduan DSHPE-së Rekomandimin e Komitetit për Komunitete që të gjenden mjete për rregullimin e ujit të pijes dhe kanalizimit te banesat sociale në fshatin Plementin, pastaj të vazhdohet me projektin tjetër.

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkësen nga Mehmetali Hasani lidhur me transportin e rregulltë të udhëtarëve në Komunën tonë në të gjitha linjat, që të bëjnë subvencionimin e linjave për kilometr të njejtë model sikurse që e ka bërë Komuna e Prishtinës.

Të nderuar, anëtarë të Komitetit kjo është hera e dytë që Kuvendi Komunal me një shkresë të tillë i rekomandon DSHPE-së, dhe ata në bazë të mundësive dhe ligjit i kanë rekomandue Kuvendit, ku Kuvendi ka ndarë mjete. Kjo, është e njejtë punë do të thotë i rekomandohet DSHPE-së dhe ata nëse, e shohin të arsyeshme dhe ka bazë ligjore e sjellin rekomandimin në Kuvend.

**Sami Ahmeti** – Po, të paktën edhe në vitin e kaluar e kemi pasë kërkësen pothuajse të njejtën, ka arsyeshmëri në kërkësen dhe mundësia sa e kuptoj unë në kërkësen është jo vetëm subvencionimi, por mundësia e bashkëpunimit me Prishtinën që me mund me bë transportin taman qysh e ka bë tash edhe Barileva trade, që e ka bë këtë marrëveshje, me kilometra po iu intereson këtyre me pague. Mirëpo, ne si Kuvend qysh thatë edhe ju nuk është se mundemi me dhënë kontributin tonë sepse duhet fillimisht me u trajtue prej Drejtorisë përkatëse, pastaj jemi ne.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht ia rekomanduan DSHPE-së, kërkësen nga Mehmetali Hasani lidhur me transportin e rregulltë të udhëtarëve në Komunën tonë në të gjitha linjat si "Kastrioti "SH.P.K "Durimi" Turs "Ylberi" Turs "Anesi" Turs dhe "Besart Ternava" që të bëjnë subvencionimin e linjave për kilometr, të njejtë model sikur që e ka bërë Komuna e Prishtinës.

**Kryesuesja** – Paraqiti kërkësen nga Bajram Krasniqi për rregullimin/zhvendosjen e rrugës në Plementin, për ndërrimin e parcelës nr.352-4 me pronar Bajram Krasniqi me një pjesë të parcelës me sipërfaqe prej 782-0 me sipërfaqe prej 2602 m<sup>2</sup> pronë e Komunës së Obiliqit.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa unanimisht ia rekomanduan DPUPKP-së, kërkësen nga Bajram Krasniqi për rregullimin/zhvendosjen e rrugës në Plementin, për ndërrimin e parcelës nr.352-4 me pronar Bajram Krasniqi me një pjesë të parcelës me sipërfaqe prej 782-0 me sipërfaqe prej 2602 m<sup>2</sup> pronë e Komunës së Obiliqit.

#### Pika 6 e rendit të ditës

**Sami Ahmeti** - Unë kërkoj që në seancën e ardhshme Drejtoria e Arsimit të vjen me një raport ose me një përgjegje lidhur me mungesën e nxemjeve që e kemi pasë brenda kësaj kohe në disa nga shkollat e Obiliqit. Nuk është ndonjë kërkësë tendencioze, por në shkollën e Milloshevës, për shembull ku e kam edhe unë vajzën ka pasë mungesa, kam grupe të shkruara që kërkojnë me ndërpren mësimin e shumë gjëra të tjera. Unë e di se minden me qenë probleme teknike, por kryesisht do të dëshironim ta kishim një raport në mënyrë që mos të kemi nevojë të kërkojmë qasje në dokumente dhe me shkue më gjatë.

Mbledhja përfundoi në ora 11:17'

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zeneli

Kryesuese e KPF

Vlora Mjekiqi Kabashi

